



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 11 pika 11.3 shkronja (a), të nenit 37, pika 37.2 dhe të nenit 38, pika 38.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.04.2008, miratoi këtë

V E N D I M

PËR RIDESTINIMIN DHE BARTJEN E PROJEKTEVE KAPITALE DHE MJETEVE TË TJERA TË APROVUARA PËR VITIN 2007 NË VITIN 2008

- I. **MIRATOHET** Vendimi për ridestinimin dhe bartjen e projekteve kapitale dhe mjeteve të tjera të aprovuara për vitin 2007 në vitin 2008.
- II. Qëllimi i ridestinimit dhe bartja e projekteve kapitale dhe mjeteve tjera të cekura nën pikën I të këtij Vendimi është që projektet e propozuara të kodifikohen dhe të bëhet realizimi i tyre.
- III. Lista e projekteve kapitale të mbetura i është bashkëngjitur këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e saj.
- IV. Bartja e mjeteve të transferuara do të ndahet për veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) Planifikimin urban;
 - b) Ofrimin e shërbimeve publike lokale dhe të infrastrukturës: furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, mirëmbajtjen e rrugëve lokale;
 - c) Shërbimet publike duke përfshirë shërbimin e zjarrfikësve dhe të emergjencës;
 - d) Shkollimin parafillor, fillor dhe të mesëm;
 - e) Kujdesin parësor shëndetësor;
 - f) Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave dhe
 - g) Sportet dhe aktivitetet e lira,

Shumat të cilat do të transferohen për veprimtaritë e cekura, i janë bashkëngjitur këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- V. Zbatimin e këtij Vendimi do ta bëjnë drejtoritë përkatëse të Komunës së Prishtinës.
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.Nr. 110-430, më 11.04.2008

KRYETARI I KOMUNËS

Prof. dr. Isa Mustafa